



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Prilijeno / Prodato / Received / Delivery	26.05	2022	2	viti god year
Organ / Njesia / Organ / Jedinica / Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SH/CK	3064/2022		1/5	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 545/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Zyle Millaku-Gojnovci në cilësinë e procesmbajtësit, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit A.nr.1976/2020 të datës 14.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, për shqyrtimin e ankesës A.Nr.545/2021, të datës 16.06.2021 e regjistruar sipas Aktgjykimit A.nr.1025/2020 të datës 16.06.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, për shqyrtimin e ankesë A.nr.62/2019, të datës 28.02.2020, të parashtruar nga ankuesja

me adrese:

kundër organit të punësimit

Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike " Transferim i përhershëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 25.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.62/2020 e datës 28.02.2020 e parashtruar nga ankuesja

II. Shfuqizohet Vendimi me numër të protokollit 02-070/01-0009085/20 i datës 31.01.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Ferizajt, Vendimi i datës 22.01.2020 me numër 01-02/20 i Kryetarit të Komunës së Ferizajt dhe Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 22.01.2020.

III. Obligohet Kryetari dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Ferizajt, për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankueses në vendin e saj të punës "Udhëheqëse e Sektorit të Rinisë" në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit" sipas Akt emërimit të karrierës të datë 01.07.2011.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunë të Ferizajt, në pozitë "Udhëheqëse e Sektorit të Rinisë", në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, sipas Akte emërimit të karrierës të datë 01.07.2011, Kryetari i Komunës së Ferizajt me datë 22.01.2020 ka nxjerrë Vendimin me numër 01-02/20 me të cilin ankuesen e ka transferuar në pozitë "Zyrtare për Shërbime Sociale", në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale-QPS, duke filluar nga data 23.01.2020.

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin e datës 22.01.2020 ka parashtruar ankesë me datës 27.01.2020 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunës e Ferizajt, i cili me datë 31.01.2020 ka nxjerr Vendimin me numër të protokollit 02-070/01-0009085/20, me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses si të papabazuar, duke lënë në fuqi Vendimin me numër 01-02/20 të datës 22.01.2020 të Kryetarit të Komunës së Ferizajt.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër të protokollit 02-070/01-0009085/20 të datës 31.01.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës e Ferizajt, brenda afatit ligjor, me datë 28.02.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil numër protokollit 7529/2020, me pretendimet ankimore kundër transferimit të përhershëm në pozitën „Zyrtare për Shërbime Sociale“, në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale - QPS, nga pozita "Udhëheqëse e Sektorit të Rinisë", në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 07.05.2020, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Divizioni i burimeve njerëzore në Komunë të Ferizajt në formë elektronike, (për shkak të situatës së pandemisë është punuar me staf të reduktuar), dhe me datë 13.05.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të Komunës së Ferizajt, lidhur me ankesën e ankueses.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 17.06.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 07.06.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1025/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 13.05.2020 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të

vendos për ankesën Anr.62/2020 të datës 28.02.2020, i cili është pranuar dhe regjistruar me datës 16.06.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe ka marrë numrin Anr.545/2021, me numër protokolli 3102/2020, për të cilën çështje ankuesja e ka njoftuar Gjykatën dhe kjo e fundit ka nxjerrë Aktgjykimit A.nr.1976/2021 të datës 14.04.2022 të cilin Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka pranuar me datë 04.05.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Aktgjykimit A.nr.1976/2021 të datës 14.04.2022 dhe Aktgjykimin A.nr.1025/2020 të datës 07.06.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën A.nr.62/2020, e datës 28.02.2020, me numër protokolli 529/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër të protokollit 02-070/01-0009085/20 i datës 31.01.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Ferizajt; Vendimi i datës 22.01.2020 me numër 01-02/20 i Kryetarit të Komunës së Ferizajt; Ankesa e datës 27.01.2020 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Ferizajt; Ndryshim plotësim i akte emërimit i datës 22.01.2020; Akte emërimi i datës 01.07.2011; Letër emërim i datës 02.09.2002; Vërtetim i datës 27.01.2020; Njoftim i datës 16.07.2008; shkresë e datës 10.01.2020 pushimit mjekësor, me analiza të datës 07.11.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2018; Përgjigje në ankese datës 13.05.2020;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e bazuar,*
sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila e kundërshton transferimit të përhershëm duke pretenduar se Vendimi i datës 22.01.2020 me numër 01-02/20 i Kryetarit të Komunës së Ferizajt, është nxjerrë në kundërshtim me ligjin në fuqi, duke theksuar se është transferon në pozitë "Zyrtare për Shërbime Sociale", në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale-QPS, nga pozita "Udhëheqëse e Sektorit të Rinisë", në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka administruar provat e lëndës ka shqyrtuar ligjshmërinë e Vendimit me numër 01-02/20 të datës 22.01.2020 të nxjerrë nga Kryetarit të Komunës së Ferizajt, dhe ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Ferizajt, në rastin e transferimit të përhershëm të nëpunëses civile, nga pozita "Udhëheqëse e Sektorit të Rinisë" në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në pozitën "Zyrtare për Shërbime Sociale", në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale - QPS, ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 si dhe paragrafin 3 nën paragrafin 3.1 të Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës; "1.Transferimi i nëpunësve civil mund të bëhet në formë të ricaktimit në vend tjetër të punës dhe si transferim i përkohshëm në detyra tjera. 2. Nëpunësit civilë mund të caktohen, si masë jo disiplinore, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në vende të tjera pune për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë", nën paragrafi 3 pika 3.1 " Ri caktimi mund të bëhet përmes : 3.1. lëvizjes paralele në një zyrë tjetër në kuadër të organizatës së njëjtë ose në organizatë tjetër në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë, brenda administratës qendrore ose komunale".

Ndërlidhur me këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të dëshmimeve të lëndës, konstaton se ankuesja sipas Akt emërimit të datë 01.07.2011, ka ushtruar pozitën 'Udhëheqëse e Sektorit të Rinisë', që në bazë të nenit 23 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është pozitë funksionale e cila hyn në kategorinë funksionale të nëpunësve civil të nivelit drejtues, ndërsa pozita ku është transferuar si "Zyrtare për Shërbime Sociale", në bazë të nenit 23 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është pozitë e cila hyn në kategorinë funksionale të nëpunësve civil të nivelit profesional, andaj mbi bazë të kësaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se me rastin e transferimit ankuesja nuk është transferuar në nivel të njëjtë të kategorisë funksionale, e që është në kundërshtim me nenin 28 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *"1.Nëpunësit civil mund të transferohet në mënyre të përhershëm në vende tjetër punë, për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme në të njëjtën kategori funksionale gradë dhe hap të pagës, brenda institucionit në shërbimin Civil. 2. transferimi i nëpunësit civil në vende tjetër të punës, me detyra dhe përgjegjësi tjera duhet të jetë në përputhje me përgatitjet profesionale të tij , dhe nuk duhet të ndikojë në zhvillimin e karrierës së nëpunësit civil"*, si rrjedhojë ankuesja me këtë transferim është degraduar në pozitë.

Po ashtu, bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se organi i punësimit gjegjësisht Komuna e Ferizajt, me asnjë provë nuk ka dëshmuar se transferimi i përhershëm i ankueses është bërë me pëlqimin e saj siç e përcaktojnë dispozitat ligjore të nenin 8 paragrafi 4 të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *"Transferimi behët në pajtim me eprorin e drejtpërdrejtë të tij, dhe me miratimin e udhëheqësit më të lartë të institucionit, si dhe me pëlqimin e nëpunësit civil"*, që në rastin konkret Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Ferizajt me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 22.01.2020, nuk ka marrë për bazë procedurat të cilat do të duhej që ti zhvilloj për transferim të përhershëm, të nëpunësve civil, në këtë rast edhe refuzimi i ankueses që të transferohet është në pajtim me nenin 8 paragrafi 3 të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, sepse ky transferim ndikuar negativisht në zhvillimin e karrierës së saj

Andaj, mbi këtë bazë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Ferizajt me rastin e nxjerrjes së Vendimi me numër 01-02/20 të datës 22.01.2020, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat të Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil , njëkohësisht Vendimi me numër 01-02/20 të datës 22.01.2020 i Kryetarit të Komunës së Ferizajt është akt administrativ i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.4 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores , ku përcaktohet se: *"1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:...1.3.është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative..... 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit."*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Ferizajt me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër të protokollit 02-070/01-0009085/20 të datës 31.01.2020, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike me rastin e refuzimit të ankesës së ankueses lidhur me transferimin e përhershëm të saj.

Nga të gjitha të lartcekura, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Ferizajt, në pajtim me këtë vendim, janë të obliguar që ankuesen t'a kthej në vendin e saj të punës sipas Akt emërimit të karrierës të datë 01.07.2011 në pozitën "Udhëheqëse e Sektorit të Rinisë" në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit'.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitave të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.545/2021.

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajt;
- Arkivit të KPMSHCK-së